

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

V E N D I M

P Ë R

MIRATIMIN E LISTËS SË BARNAVE QË RIMBURSOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE TË MASËS SË MBULIMIT TË ÇMIMIT TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 37, të ligjit nr.105/2014, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", dhe të pikave 2, shkronja "b", e 6, të nenit 10, të ligjit nr.10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës nr.1 të barnave të rimbursueshme që tregtohen nga farmacitë e spitaleve, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Miratimin e listës nr.2 të barnave që rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 3. Miratimin e masës së mbulimit të çmimeve të barnave të rimbursueshme, në masën 50% - 100%, sipas grupeve terapeutike, dhe barnave të dhëna në pasqyrën nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 4. Miratimin e marzheve të tregtimit për barnat e listës së rimbursueshme, përkatësisht, në masën 8%, për tregtimin me shumicë, dhe 24%, për tregtimin me pakicë.
 5. Miratimin e marzheve të diferencuara të tregtimit me shumicë dhe pakicë të disa barnave të listës nr.1 dhe listës nr.2, të përcaktuara në pasqyrën nr.2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 6. Ngarkohet Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor të përcaktojë kufizimet në përdorimin, sasinë dhe kohëzgjatjen e trajtimit me barnat e kësaj liste.
 7. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i miratuar për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për vitin 2015.
 8. Vendimi nr.135, datë 12.3.2014, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre", të ndryshuar, shfuqizohet.
 9. Ngarkohet Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare" dhe i fillon efektet e tij në datën 1.4.2015.